

të mbaruar shkollën e mesme teknike. Punonte si çelësabërës, por pas trajnimit për oficer police në Vushtrri/Vučitrn, u punësua në SPB-në e Gjakovës/Đakovica. Në orët e hershme të mëngjesit, më **20.08.1998**, Milomiri u nis me njësitin e tij drejt **Zoqishtës/Zočište**. Në rrugë e sipër, hasën në një barrikadë të UÇK-së, pjesëtarët e së cilës menjëherë shtënë mbi kolonën policore. Një nga predhat e ka qëlluar kupolën e autobлиндës policore të quajtur *Praga*, mbi të cilën gjendej Milomiri. U plagos rëndë nga eksplodimi. Ka dhënë shpirt në rrugë për në spital. Familjarët e kanë varrosur Milomirin në varrezat e Krushevës.

Burimet: deklarata M.G. FDH-32481; *Dnevnik od 19. do 25. avgusta*, Ilustrovana politika, 01.08.1998, FDH-29547; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRF, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 478, 938; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 36.

Ranko (Vojislav) Perenić

(25.9.1958, serb nga Fushë Kosova/Kosovo Polje, shofer, dy fëmijë)

Đuro (Andrija) Slavulj

(24.12.1962, serb nga Prishtina/Priština, gazetar)

Đuro Slavulj ka qenë gazetar, ndërkaq Ranko Perenić shofer në *RTV Prishtina*. Ditën e premte, më **21.08.1998**, ata u nisën me makinën zyrtare të tipit *Zastava 128* për në Zoqishtë/Zočište, për të bërë kronikën për kthimin e priftërinjve në manastirin *Sveti Vrač* të *Kozmes dhe Damjanit*. Herën e fundit mbaheshin në mend të shiheshin të gjallë kur, rreth orës 14:00, kaluan pranë **Hocës së Madhe/Velika Hoča**. Nga ajo ditë, atyre u humbet çdo gjurmë. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rastet e tyre janë evidentuar në lëndët me numrat YUK-050054-01 dhe YUK-050052-01.

Burimet: *Dnevnik od 2. do 8. septembra*, Ilustrovana politika, 12.09.1998, FDH-32222; deklarata S.P, FDH-5520; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; SMIP, *Teroristički...*, III, 106-107; AIS, *Zona...*, 66, FDH-16913; *Šta je sa očetim novinarima*, Oteta istina, num.

15, korrik-shtator 2008, 30, FDH-19947; FPRRZHKeM, *Regjistri i të rrëmbyerve...*, FDH-17551, deklarata J.S, FDH-34612

Haki (Ismajl) Gashi

(4.07.1935, shqiptar nga Zoqishta/Zočište, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, tre fëmijë)

Familja e Hakiut jetonte në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërkaq ai rrinte te i vëllai dhe familja e tij në Zoqishtë/Zočište. Pas sulmit mbi Rahovecin/Orahovac, formacionet serbe kanë hyrë në fshat më **21.08.1998**. E zunë pozicionin te manastiri dhe e nisën bombardimin e fshatit. I vëllai me familjarët e braktisën fshatin, por Hakiu vendosi të mos lëvizte nga fshati **Zoqishtë/Zočište**. Pas pesë javësh, përderisa qëndronte në një fshat të Suharekës/Suva Reka, i vëllai dëgjoji se Hakiun e kishin vrrarë. Kur, në muajin shtator të vitit 1999, ai u kthye në fshat, tentoi që ta gjente trupin e të vëllait, por pa sukses. Nuk kishte as gjurmë për vrasjen e tij. Rasti i Hakiut është evidentuar nga KNKK-ja më 30.08.2006. Lënda e tij në regjistrin e të zhdukurve e mban numrin BLG-803428-01.

Burimet: deklarata N.G, FDH-13978; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Sefi (Sherif) Shala

(1943, shqiptar nga Zoqishta/Zočište, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, katër fëmijë)

Në datën **21.08.1998**, forcat serbe e nisën bombardimin e fshatit, gjë që i detyroi banorët që ta braktisnin fshatin, në mesin e tyre edhe familjarët e Sefiut. Por, ai ndenji në shtëpi [**Zoqishtë/Zočište**]. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët e tij e shihnin Sefiun të gjallë. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është evidentuar në lëndën që e mban numrin BLG-803797-01.

Burimet: deklarata H.S, FDH-13984; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; *Serb Forces Shell Rahovec and Suhareka Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 20.08.1998, FDH-29444; *90 Albanian Houses Burnt by Serbs at Zoqishtë Village od Rahovec*, pasqyra e lajmeve, KIC, 24.08.1998, FDH-29504.